



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË MJEDISIT

Nr. 4704 Prot.

Tiranë, më 17.05. 2019

Nr. Identifikimi 458

Vendimi 26

### DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

#### VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

**Person fizik:** "Ismail Ymeraj" sh.p.k  
**Nr. NIPT-i:** L53205404R  
**Adresa e selisë:** Lagjja Buz Madh, rruga "Buz Madh Cakran", banesa private 526, Cakran, Fier.

Për të zhvilluar projektin: "**Instalime për rritje intensive të pulave me qëllim tregtimi të mishit të gjallë**"

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për Verësimin e Ndikimit në Mjedis", Shtojca I, 17. Instalime për mbarëshkrimin intensiv të pulave ose derrave me mbi / a) 1 000 krerë për pulat që rriten për mish, 20 000 vende për pulat që rriten për vezë;

**Vendndodhja:** Buz Madh, Cakran, Fier.

#### Të dhëna teknike:

Sipërfaqja e përgjithëshme e truallit: 1 900 m<sup>2</sup>  
Sipërfaqja e truallit e zenë nga 1 kapanon: 575 m<sup>2</sup>  
Kapaciteti mbajtës i repartit të ushqimit: 30 ton  
Kapaciteti total i kompleksit: 15 000 krerë

*(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)*

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

**Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;**

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

### **1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:**

**Drejtoritë Teknike të Ministrisë së Mjedisit shprehen:** Të mbahen parasysh kërkesat e legjislacionit në fuqi në fushën e mbetjeve;

- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23. 04. 2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme;
- Mbetjet inerte që do të gjenerohen të trajtohen sipas kërkesave të VKM nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte";
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 18.2.2005, "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve" të ndryshuar;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 11.06.2014 "Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme;
- Subjektet që do të transportojnë apo transferojnë mbetjet të jenë të pajisur me licencë të tipit III.2.B, si detyrim i ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar.
- Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr. 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën "a" apo "b" të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

### **2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:**

*Konsultimi me publikun:* Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu sigurova të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

### **3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;**

Zhvillimi i aktivitetit:

- Nuk prek zona të mbrojtura

### **4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme.**

- 4.1. Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plote me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve nënligjore në fuqi.
- 4.2. Ky Vendim është i vlefshëm pasi subjekti të marrë miratim nga institucionet përkatëse për këtë lloj aktiviteti.
- 4.3. Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulturi, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.
- 4.4. Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë.
- 4.5. **Të kryhen punime vetëm në gjurmët e projektit të propozuar.**
- 4.6. Në asnjë mënyrë mos të ketë prerje pemësh.
- 4.7. Të bëhet rrethimi i zonës ku do të realizohen punimet, për të shmangur hyrjet e pautorizuara.
- 4.8. Masa e dheut e gjeneruar nga operacionet e gërmimit, të sistemohet në një vend të caktuar dhe të ruhet për qëllimin e rehabilitimit.
- 4.9. Të merren masa për të parandaluar rëniet e zjarrit gjatë realizimit të punimeve në terren dhe të sigurohen mjetet e nevojshme të ndërhyrjes në rast të rënies së zjarrit (zjarrfikse të lëvizshme, bombula me shkumë, etj);
- 4.10. Niveli i zhurmave gjatë procesit të jetë brenda normave të lejuara dhe të punohet në orare kur shqetësimi i banoreve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët
- 4.11. Operacionet për zbatimin e projektit (ndërtimi) të përdorin sa më shumë të jetë e mundur infrastrukturën egzistuese të transportit (rrugën dhe rrjetet egzistuese).
- 4.12. Subjekti të kujdeset për menaxhimi e mbetjeve të krijuara nga veprimtaria, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimet e caktuara nga njësia vendore.
- 4.13. Mbetjet organike të vendosen në kontenierë të mbyllur, dhe të trajtohen sipas kushteve të vendosura nga autoritetet kompetente.
- 4.14. Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme cdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.15. Kompania të ndjek me përpikmëri projektin teknik për të evituar erozionin e tokës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
- 4.16. Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 4.17. Furnizimi me ujë të pijshëm të bëhet në tubacionin kryesor, me miratimin të Shoqërisë Anonime "Ujësjellës-Kanalizimeve".
- 4.18. Të instalohet impianti i trajtimit të ujërave të ndotura që gjenerohen nga aktiviteti i therjes para shkarkimit të tyre në kanalizimet kryesore.
- 4.19. Furnizimin me energji elektrike të bëhet konform kërkesave e me miratimin të organeve kompetente.
- 4.20. Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.21. Para fillimit të veprimtarisë të trajnohen të gjithë punëtorët e subjektit si dhe të njihen me termat dhe kushtet e sipercituara në Vendim.
- 4.22. Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e godinës së shërbimit për të minimizuar ndikimet në mjedis.

- 4.23. Produktet të magazinohen në ambiente frigoriferike i cili duhet të ndërtohet sipas kushtet teknike, brenda sipërfaqes së ndërtimit të miratuar.
- 4.24. Të respektohen kushtet Higjeno-Sanitare të ambienteve të vendosura nga Instituti i Shëndetit Publik.
- 4.25. Kompania duhet të respektojë gjithashtu edhe kushtet e vendosura në raportin e VNM-së që është paraqitur në aplikim si dhe të ketë parasysh ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- 4.26. Në përfundim të punimeve, të sillet pranë AKM-së një raport mbi gjendjen e mjedisit të shoqëruar me foto dhe mbi punimet rehabilituese gjatë gjithë vijës së projektit.
- 4.27. Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit nr. 60/2014 datë 19.6.2014, “Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, të ndryshuar, Shtojca I, duhet t’i nënshtrohet procedurave për paisje me Leje Mjedisore.

*Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.*

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM**

  
**EDISON KONOMI**

  
**MINISTRI**

  
**BLENDI KLOSI**




Figura 2 – Pozicioni i objektit mbi imazh satelitor

Tabela 1 - Koordinatat e objektit

Nr.	Koordinatat e objektit	
	X	Y
1	4382372.31	4496043.64
2	4382378.52	4496034.49
3	4382449.51	4496071.15
4	4382445.54	4496078.91